

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON: 07/03/2024

PRIMLJENO:

Nr.No.Br. 02/114



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/_____

Datë: 04.03.2024

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 40 paragrafi 2 shkronja (e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/ 2008", në bazë të nenit 13 , nenit 23, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 datë:14.09.2023, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -II- (dytë) të rregullt të mbajtur me datë: 29.02.2024 merr këtë:

VENDIM

1.Miratohet formimi i Komisionit të ankesave, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë në Komunën e Malishevës.

2.Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi Komisioni do të jetë në këtë përbërje:

2.1. Astrit Sertolli-Nisma Socialdemokrate-anëtar

2.2. Zamire Morina –LDK-anëtare

2.3. Valmir Gashi-anëtar

2.4. Fadil Shala-anëtar

2.5. Mërgim Krasniqi-anëtar


3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes Kryesuesit të Kuvendit.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës,

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS NË MALISHEVË



20/02/2024

04/188

Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë: 20/02/2024

Nga: Kryetari i Komunës së Malishevës, Ekrem Kastrati.

Për: Kuvendin e Komunës së Malishevës
Kryesuesit z. Argjend Thaçi.

Datë: 20.02.2024

Kopje: Arkivit të komunës



Lënda: Kërkesë për formimin e komisionit ankesave, me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, në Komunën e Malishevës.

Të nderuar anëtarë të kuvendit të komunës së Malishevës,

Bazuar në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Ligji, nr.06/L-092, dt.07.03.2019, neni 18, propozojë formimin e komisionit ankesave të palëve në procedurë, me rastin e dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, në përbërje prej pesë (5) anëtarëve.

Formimi i këtij komisioni përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, dy (2) anëtarë i propozon kryetari i komunës dy (2) anëtarë i propozon kuvendi dhe një (1) anëtar propozohet nga sektori jo qeveritar.

- Mandati i këtij komisioni është 2 (dy) vjeçar !

Ju falënderit për mirëkuptim !

Me respekt,